

Pse vetëvendosje?

Vetëvendosja është e drejtë e të gjithë popujve të kolonizuar.

Mungesa e përgatitjes në fushat politike, ekonomike, shoqërore, apo në atë të arsimit kurrë nuk duhet të merret si pretekst për të vonuar pavarësinë. (Rezoluta 1514 e OKB-së, më 1960)

VETËVENDOSJE!
<http://www.vetevendosje.org>

Fletushkë e Lëvizjes VETËVENDOSJE!

KËTË JAVË: Përmbledhje e vitit 2008

Kundërshtimi ndaj EULEX-it

Ky vit filloi me kundërshtimin ndaj EULEX-it në bazë të asaj se ky mision i ri ndërkombëtar në Kosovë do të ketë fuqi ekzekutive dhe imunitet si UNMIK-u. Më 22 janar, aktivistët vendosën pusulla ngjitëse nëpër semaforët në Prishtinë. Në pusullën e vendosur në dritën e kuqe shkruante 'JO EUMIK' dhe në dritën e gjelbër 'VETËVENDOSJE!'.

Më 6 shkurt, dy ditë pas aprovimit të misionit të ri të EULEX-it nga Këshilli i Veprimtimit të Përbashkët, i cili u bazua në Rezolutën 1244 të OKB-së, aktivistët shkruan 'EULEX' me një X të madh mbi të nëpër mure anekënd Kosovës.

Kundërshtimi ndaj EULEX-it vazhdoi gjatë gjithë vitit dhe e arriti kulmin me dy demonstrata masive kundër Gjashtë Pikave, të organizuar me 20 organizata tjera. Përveç kësaj, Lëvizja VETËVENDOSJE! bëri dy analiza të detajuara të bazës ligjore, kompetencave, zinxhirit komandues dhe imunitetit të misioneve ndërkombëtare në Kosovë. Më 13 tetor, 3,000 posterë 'J'accuse' kundër Yves de Kermabon u vendosën anekënd Kosovës. Posterët e tregonin atë së bashku me kryekomandantin e ushtrisë serbe, Dragan Paskas, të cilin ai e pati ftuar në ceremoninë e tij lamtumirëse në Kosovë në vitin 2005, kur de Kermabon ishte në krye të KFOR-it.



Gjykimi i Albin Kurtit

Në mes të 10 shkurtit dhe 19 dhjetorit 2007, Albin Kurti mbahej në burg dhe në burg shtëpiak, nën akuzat lidhur me demonstratën e 10 shkurtit 2007, ku policia e UNMIK-it i qëllon për vdekje Arben Xheladinin dhe Mon Balajn, dhe i plagosi edhe mbi 80 të tjerë. Në gjykimin kundër Albin, UNMIK-u ishte prokurori, palë e dëmtuar dhe gjykatës. Albini u arrestua sërish më 30 janar 2008 pasi refuzoi t'u përgjigjej ftesave të gjykatës për gjykim. Një numër i avokatëve mbrojtës shqiptarë e respektuan mosnjohjen e sistemit gjyqësor të UNMIK-it nga ana e Albin. Ata refuzuan të paraqiteshin në mbrojtje të tij dhe kjo e arriti kulmin kur Ramë Gashi, kryesuesi i Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës, refuzoi ta emëronte një avokat tjetër për rastin. Gjykimi u suspendua.

Më 10 shkurt, në përvjetorin e demonstratës, u mbajt një tubim përkujtimor për Arbinin dhe Monin dhe një pllakë përkujtimore u vendos në rrugën "Nëna Tereze", pranë vendit ku u vranë ata të dy.

Kundërshtimi ndaj Planit Ahtisari

Lëvizja VETËVENDOSJE! e ka kundërshtuar Planin Ahtisari në mënyrë të parreshtur gjatë gjithë vitit, duke u bërë thirrje deputetëve të votojnë kundër aprovimit të ligjeve të Planit Ahtisari më 15 shkurt me 'procedurë të veçantë'. Lëvizja në mënyrë të vazhdueshme i ka bërë thirrje qeverisë që të mos e pranojë Planin Ahtisari, i cili iu imponua Kosovës si çmim edhe pse Serbia nuk e njohu pavarësinë e Kosovës sipas Planit të Ahtisari. Kundërshtimi ndaj planit ka qenë në thelbin e aktiviteteve të Lëvizjes gjatë gjithë vitit.

Më 15 mars, 26 persona humbën jetën në eksplozimin në Gërdec. Aktivistët bënë homazh me ceremoni të ndezjes së qirinjve në rrugën "Nëna Tereze" dhe dhuruan gjak për viktimat.

Nr.127, 29 Dhjetor 2008

Shpallja e pavarësisë

Para dhe pas shpalljes së pavarësisë, Lëvizja VETËVENDOSJE! e ka bërë të ditur se kjo shpallje nuk do t'i sjellë Kosovës pavarësi të njëmendtë dhe tërësi territoriale. Shpallja ishte një hap para për shkak të njohjes ndërkombëtare të pavarësisë, por tri hapa mbrapa për shkak se lidhej me zbatimin e Planit Ahtisari, mikëqyrjen ekzekutive nga dy misione ndërkombëtare dhe për shkak se i lejonte Serbisë që ta zgjerojë kontrollin e vet brenda Kosovës.

Zgjerimi i kontrollit nga ana e Serbisë ndodhi me shpejtësi në mes shpalljes dhe mesit të marsit. Strukturat paralele të Serbisë i dogjën dy vendkalimet kufitare 1 dhe 31 në mes Kosovës dhe Serbisë; i okupuan hekurudhat e Kosovës; policët serbë të Kosovës e bojkotuan Shërbimin Policor të Kosovës dhe e okupuan gjykatën në Mitrovicën e veriut, duke e vrarë një polic të Ukrainës. Askush nuk u akuzua për këto krime.

Më 23 mars, Lëvizja VETËVENDOSJE! u shpërndau dhëmbë artificiale institucioneve të Kosovës, për të simbolizuar mungesën e dhëmbëve të tyre politikë. Përveç kësaj, ne e bëmë një listë me 10 hapat të cilët do të duhej të ndërmerreshin për të qenë të pavarur. Këtu u përfshi krijimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe transformimi i TMK-së në ushtri të njëmendtë; formimi i aleancave mbrojtëse me vendet mike dhe bashkëpunimi me Shqipërinë në të gjitha fushat; kontrolli i plotë i policisë së Kosovës; largimi i misioneve të UNMIK-it dhe BE-së dhe dhënia fund misioneve ndërkombëtare ekzekutive në Kosovë dhe hedhja poshtë e Planit Ahtisari.

Qartësimi i kushtetutës

Kushtetuta e Kosovës u aprovua me 15 qershor me edhe një 'procedurë tjetër të veçantë', e cila nuk u lejoi deputetëve ta shprehin kundërshtinë e tyre publikisht. Lëvizja mori pjesë në të gjitha mbledhjet publike të mbajtura në lidhje me kushtetutën për t'ia bërë

Pse vetëvendosje?

Vetëvendosja është e drejtë e të gjithë popujve të kolonizuar.

Mungesa e përgatitjes në fushat politike, ekonomike, shoqërore, apo në atë të arsimit kurrë nuk duhet të merret si pretekst për të vonuar pavarësinë. (Rezoluta 1514 e OKB-së, më 1960)

VETËVENDOSJE!
<http://www.vetevendosje.org>

Fletushkë e Lëvizjes VETËVENDOSJE!

Nr.127, 29 Dhjetor 2008

popullit me dije se dispozitat e saj ishin të papranueshme dhe kundërtënese. Derisa në një anë deklaronte se Kosova ishte e pavarur dhe demokratike, ajo gjithashtu theksonte se Plani Ahtisari është dokumenti më i lartë ligjor në vend dhe u jep fuqi ekzekutive misioneve ndërkombëtare në Kosovë. Kështu Kushtetuta e rikonfirmoi varshmërinë e Kosovës dhe *mungesën* e sovranitetit të saj.

Kundërshtimi ndaj zgjedhjeve të Serbisë brenda Kosovës

Serbia paralajmëroi se do të mbante zgjedhje parlamentare dhe komunale brenda Kosovës më 11 maj. Edhe pse politikanët e UNMIK-ut dhe të Kosovës deklaruan se këto zgjedhje si dhe strukturat të cilat do të zgjedheshin gjatë tyre do të ishin joligjore, ata nuk bënë asgjë për t'i parandaluar zgjedhjet. Ata deklaruan se nuk do t'i njihnin udhëheqësit e ri të zgjedhur, ndërsa tash megjithatë të gjithë ata po bashkëpunojnë me ta. Lëvizja VETËVENDOSJE! organizoi një demonstratë masive më 9 maj kundër zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë. Aktivistët hodhën grumbuj mbeturinash në oborret e UNMIK-ut, Kuvendit dhe Qeverisë, dhe i spërkatën ndërtesat e tyre me ujë kanalizimi.



Parullë kundër EULEX-it, 2 dhjetor

Identiteti Kombëtar

Një nga synimet e Lëvizjes për këtë vit ka qenë mbrojtja e së drejtës për ta shprehur identitetin kombëtar shqiptar. Përderisa serbët në Kosovë po bëhen më serbë, nga shqiptarët po kërkohet me Planin e Ahtisarit të bëhen një nga gjashtë komunitetet etnike përkundër realitetit ku 92% e popullsisë së Kosovës janë shqiptarë. Kjo u manifestua, për shembull, në transformimin e festës kombëtare 28 Nëntorit në 'ditë të komunitetit', dhe futjen tinëzore të flamurit të ri për Kosovën në Kuvend pa kurrfarë debati apo procedure votimi.

Më 10 qershor, aktivistët u mbledhën në Prizren për ta shënuar përvjetorin e 130-të të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kjo Lidhje ishte lidhja e parë kombëtare shqiptare, e cila e mobilizoi luftën kundër vendimeve të Kongresit të Berlinit për t'i aneksuar trojet shqiptare. Aktivistët e shpalosën një flamur të madh shqiptar në Kalanë e Prizrenit.

Më 28 gusht, Lëvizja u bashkangjiti 17 grupeve dhe organizatave të tjera për të biseduar rreth sfidave politike, ekonomike dhe shoqërore me të cilat ballafaqohen shqiptarët sot. Si rezultat i mbledhjes u vendos të mbaheshin një varg ligjëratash lidhur me çështjet shqiptare që do të fokusoheshin në konceptin e unifikimit dhe të festohej 28 Nëntori në Tiranë, Shkup, Prishtinë dhe Preshevë. U mbajtën tri koncerte në këto qytete dhe në Prishtinë, një panair kombëtar për nder të prodhimeve dhe kulturës shqiptare u organizua në rrugën Nëna Terezë. Ky grup e ka marrë emrin Rrjeti i Organizatave Shqiptare RROSh).

Përvjetori i tretë
Përvjetori ynë i 3-të ishte më 12 qershor 2008.

Vaji helmues disulfurik në Mitrovicë

Në mes të 3 korrikut dhe 22 gushtit, aktivistët iu bashkangjitën popullit të Mitrovicës për të protestuar kundër zbrazjes së kontejnerëve me vaj toksik sulfurik në deponë në dalje të Mitrovicës. Si rezultat i protestave të vazhdueshme, të cilat përfshinë blokimin e rrugës kryesore, kohë kjo gjatë së cilës aktivistët u arrestuan dhe u rrahën, qeveria më në fund e gjeti mënyrën për largimin e kontejnerëve të helmueshëm dhe shkatërrimin e tyre jashtë Kosovës.

Kundër Gjashtë Pikave

Më 19 nëntor dhe 2 dhjetor, Lëvizja VETËVENDOSJE! bashkorganizoi dy demonstrata masive popullore kundër Gjashtë Pikave të Ban Ki-moon-it dhe Serbisë dhe kundër Planit Ahtisari. Me mijëra njerëz morën pjesë në të dy demonstratat, të cilat u bashkorganizuan nga rreth 20 grupe dhe organizata të tjera nga shoqëria civile në Kosovë. Lëvizja VETËVENDOSJE! paraqiti propozimet si të merret kontrolli i tërësisë territoriale të Kosovës dhe të shpërbëhen strukturat paralele të Serbisë brenda Kosovës. Ne gjithashtu propozuam se në vend se të harxhohen kot 365 milionë euro për pagimin e vetëm një viti të misionit masiv të rendit dhe ligjit EULEX-it në Kosovë, BE-ja duhet ta investojë atë shumë në infrastrukturën shoqërore dhe ekonomike të Kosovës, për shembull, në universitete e spitale.



Demonstrata e 19 nëntorit